

BAÇELOR
DEPARTAMENTI I GAZETARISË
PROGRAMI I STUDIMEVE: GAZETARI
SILABUSI I LËNDËS: RAPORTIMI

1. Titulli i lëndës: RAPORTIM

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë
Titulli i lëndës:	Raportimi
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, semestri i II-të
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Kreditë ECTS:	8
Koha / Vendi:	Ligjërata: Ushtrime:
Mësimdhënësi:	Prof.Asst.Dr. Muhamet JAHIRI Asistent: MA Blerta BLAKAJ
Të dhënat kontaktuese:	Email: muhamet.jahiri@uni-pr.edu , Tel: +383(0)38222970
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë e inkadron studentin në studimet themelore mbi gazetarinë dhe njëherësh e pajis me njohuritë fillestare për profesionin e gazetarit. Kombinimi i mësimit teorik me punën praktike, gjatë tërë vitit akademik, i mundëson studentit të përvetësojë nocionet dhe informacionet themelore të gazetarisë dhe t'i zbatojë mënyrat standarde të shkrimit gazetaresk konkretisht, duke u motivuar dhe duke u kalitur për profesionin e gazetarit
Qëllimet e lëndës:	E kupton se raportimi është një proces i ndërlikuar dhe që kërkon shumë përgjegjësi profesionale, e kupton se raportimi nga një fushë në një tjetër ka dallime esenciale dhe përgatitja për secilin prej tyre është esenciale për raportim të suksesshëm E kupton se s atë rëndësishme janë burimet e informimit/raportimit, si ngrihen dhe si ruhen ato burime. E kupton ndërvlerësinë e shoqërisë, fateve të njerëzve dhe kultivon një ndjenjë respekti për interesat e publikut dhe të medias e kupton mënyrën e vlerësimit të ngjarjeve që duhet të tematizohen, fiton aftësi që të shkruajë lajmin dhe raportin sipas strukturës së piramidës së përmbytur, e kupton se raportimi paraqet çelësin i suksesit në gazetari

Rezultatet e pritshme të nxënies:	1. I din mënyrat e shkrimit të raportit nga vendi i ngjarjes 2. I njeh kriteret themelore për përcaktimin e vlerës së lajmit/raportit dhe të ngjarjeve 3. Mund të shkruajë lajmin dhe raportin sipas modeleve të gazetarisë bashkëkohore 4. Mund të raportojë nga ngjarje të ndryshme, sipas standardeve të gazetarisë bashkëkohore
-----------------------------------	--

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	15	1	15
Konsultime me mësimpldhënësin	10 min	15	2.5
Puna në terren	2	15	30
Testi, punimi i seminarit	8	2	16
Detyrë shtëpie	2	15	30
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	2	4
Projektet, prezantimet, etj.	1	2	2
Total			209.5 orë

Metodat e mësimdhënies:	Mësimdhënia në këtë lëndë është e kombinuar: ligjërata dhe ushtrime. Në ligjërata aplikohet metoda interaktive, por pjesa kryesore mbulohet nga ligjërimi i mësimdhënësit. Ndërsa, në ushtrime bëhet shkëputja e teksteve nga gazetatat e ditës, analiza e tyre në bazë të mësimëve paraprake, rishkrimi i tyre me metodat shkollore dhe debati e vlerësimi i përbashkët për variantet e teksteve të përfutuara nga studentët. Aplikohen edhe teste periodike, së paku tre gjatë një semestri, për të ndjekur shkallën e mësimnxënies.
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrja e rregullt 5% Vlerësimi i detyrave dhe ushtrimeve 20% Testi 15 % Pjesëmarrja aktive në mësim 10% Provimi përfundimtar 50%
Literatura primare:	ABC-ja e gazetarisë Një manual për studentë, pedagogë dhe praktikantë, Konard, Claudia Mast Milazim Krasniqi, Hyrje në gazetari, Rozafa, Prishtinë, 2008

	Missouri Group “Raportimi dhe shkrimi i lajmit” Eric Scherer, “A na duhen më gazetarët?” Papirus 2012 Melvin Mensher, Raportimi dhe shkrimi i lajmeve, Onufri, (botimi i pestë), Tiranë, pa datë botimi Mol Rus-Shtefan, Gazetaria, Tiranë, 2012 Gazetaria moderne, (Reporting for the modern media), Tiranë, 2001 Grup autorësh, Gazetaria, Tiranë
Literatura shtesë:	Albert, Pierre, La Presse, PUF, 2002 Boriqi, Hamit,:Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptare, Tiranë, 1997 Gidens, Anthony: Sociologjia, Fondacioni Soros&Çabej, Tiranë, 1997 Grup autorësh, Gazetaria, Tiranë, 2002 Lambeth, B. Edmund, Gazetaria me përkushtim, Tiranë, 1998 Malovic, Stjepan: Osnove novinarstva, Golden marketing-Tehnicka knjiga, Zagreb, 2005 Manual për Gazetarët, Dituria, Tiranë, 1990 Meyer, Filip: Gazetaria e saktë, Koçi, Tiranë, 2006 Gazetat online

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Raportimi nga vendi i ngjarjes
Java 2:	Raportimi për fatkeqësitë në komunikacion
Java 3:	Raportimi për katastrofat dhe fatkeqësitë e mëdha - analiza e Tabelës së Brus Garisonit për raportimin e fatkeqësive
Java 4:	Raportimi nga konferencat e shtypit
Java 5:	Raportimi për krimet
Java 6:	Raportimi nga gjykatat
Java 7:	Raportimi nga ngjarjet kulturore
Java 8:	Vlerësimi i parë intermediary
Java 9:	Raportimi nga mbledhjet dhe tubimet politike
Java 10:	Të shkruar për Web-in
Java 11:	Raportimi i shkencave sociale
Java 12:	Raportimi nga ngjarjet sportive
Java 13:	Vlerësimi i dytë intermedier
Java 14:	E drejta në media
Java 15:	Etika dhe normat profesionale
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes	
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: Standard	